

AKTI I THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR

"TATA AUTO Transport" Sh.p.k.

Sot, me date 14 shtator 2021, ne rrugen CARJES 03870012; Nd. 14; H. 1; ; BALDUSHK; FUSHAS; 1035; TIRANË, Shqiperi:

Zoti Redon Meta, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues bne Baldushk, Tirane, i datelindjes 07.09.1995, i identifikuar me kartë identiteti nr. 035724330 dhe nr. personal J50907060D, lëshuar me date 29.01.2020, me zotësi te plote juridike dhe zotesi per te vepruar;

NENI 1

EMËRTIMI I SHOQËRISË

Themelohet shoqëria me emrin "TATA AUTO Transport" Sh.p.k., Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët qe mund te krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do te ketë selinë dega. Shoqëria do te ushtroje veprimtarinë e saj ne baze te këtij Akti Themelues dhe Statutit te shoqërisë te miratuar nga ortaku dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

NENI 2

SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë "TATA AUTO Transport" Sh.p.k.. do te jete ne adresen ne rrugen CARJES 03870012; Nd. 14; H. 1; ; BALDUSHK; FUSHAS; 1035; TIRANË, Shqiperi. Shoqeria, per nevoja te zhvillimit, mundet sipas diskrecionit te saj te hape dege te tjera dytesore, zyra perfaqesimi dhe zyra administrative, ne territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 3

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e shoqërisë do te jete e pakufizuar nga momenti i regjistrimit te saj pranë Qendrës Kombëtare te Regjistrimit. Shoqëria e fiton personalitetin e vete nga momenti i regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit (QKB).

NENI 4

OBJEKTI I SHOQËRISË

Shoqëria ka për objekt:

Auto Transport, import eksport nacional dhe internacional, brenda dhe jashte territorit te shqiperise per vete dhe per te tretet, gjithashtu dhe leshim te Automjeteve me qera brenda dhe jashte territorit te Shqiperise.

NENI 5

AKTIVITETE TE TJERA



Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të bashkëpunojë me persona fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj, duke pasur të drejtën për të hapur degë apo zyra përfaqësimi edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 6

KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali i shoqërisë tregtare private "TATA AUTO Transport" Sh.p.k do të jete Leke 100,000 (Njëqind mijë leke). Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (nje) kuote:

- 1 (nje) kuotë e barabartë me 100% të kapitalit të zotëruar nga Z. **Redon Meta**;
 - Kapitali fillestar i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet dhe është totalisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.
- 5.2 Kuotat e kapitalit derdhen nga ortaku në Bankë, në llogarinë bankare të shoqërisë dhe derdhjet e kuotave regjistrohen në librin e llogarisë së shoqërisë.
- 5.4 Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar janë të nënshkruara nga ortaku i shoqërisë.
- 5.5 Ortaku ka të drejtë të tërheqë fondet e depozituara si kapital themeltar të shoqërisë, në rast se shoqëria nuk regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, brenda 6 (gjashtë) muaj nga data e depozitimit të fondeve.

NENI 7

PARASHIKIME GARANCIE DHE ZHVILLIMI

Ortaku i shoqërisë angazhohet me detyrën për të shtuar volumin e veprimtarisë së shoqërisë, të respektojë detyrimin e ruajtjes së sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar dhe të mos demtojë interesat e shoqërisë.

NENI 8

DREJTIMI I SHOQËRISË

Administratori i vetëm i Shoqërisë është Z. **Redon Meta**, shtetas shqiptar, lindur dhe banues në Baldushk, Tiranë, Shqipëri, i datelindur 07.09.1995, i identifikuar nëpërmjet leternjoftimit ID me nr. 035724330 dhe nr. personal J0907060D.

Administratori i vetëm emërohet me një afat 5 (pese) vjeçar duke filluar nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB, me të drejtë rrimërimi në qofte se do të emërohet serish administrator nga asamblja e ortakeve. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë për shkarkimin e tij përpara mbarimit të periudhës së emërimit. Administratori ka të drejtë të japë dorëheqjen e parakohshme, me aprovim nga ana e asamblese së përgjithshme, sipas procedurave të parashikuara me ligj.

Asambleja e përgjithshme mund të emërojë edhe me shumë se një administrator, të çfarëdo kombësie dhe të jashtëm për shoqërinë. Në rastin e emërimit të një apo me shumë administratorëve në fuqi, secili nga administratorët mund të ushtrojë të gjitha tagrat e përfaqësimit dhe të firmes, përveçse i perket



kompetencave te veta, te përcaktuara paraprakisht nga asamblea e përgjithshme, regjistruar prane QKB-se. Ortaku do te jete individualisht përgjegjës per përmbushjen e funksioneve te dhëna nga ligji për administratorin dhe do ti komunikojte te tjereve ose administratorit tjetër veprimet nga ai te kryera. Administratori ose administratorët kane detyrimin te raportojnë mbi veprimtarine e tyre përpara asamblese se përgjithshme, sa here kërkohet nga ortaku/ortaket.

NENI 9

FITIMET E SHOQËRISË

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakut/ortakeve te saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet per kete procedure.

NENI 10

EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORIT/ADMINISTRATOREVE

Asambleja e përgjithshme emëron dhe revokon administratorin ose administratorët ne fuqi dhe mund te emërojte edhe administratore te tjerë me detyra te përcaktuara me ligj dhe ne autorizim.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e zakonshëm te shoqërisë, te përfaqësoje shoqërinë ne marrëdhëniet me te tretet me përjashtim te kompetencave qe vete ligji apo statuti u jep shprehimisht ortakeve.

Për çështje te rëndësish se veçante administratori konsultohet me ortaket dhe merr masat e përcaktuara nga asambleja e ortakeve, te marra me shumicat e parashikuara me ligj.

NENI 11

TABELA, MARKA DHE SHENJA DALLUESE

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa te zakonshme, te realizuar sipas parashikimeve te ligjit ne fuqi dhe mund te ketë një marke te veten.

NENI 12

JURIDIKSIONI

Për te gjitha konfliktet qe mund te lindin midis ortakut/ortakeve, dhe Shoqërisë dhe Shoqërisë dhe administratorit/administratoreve do te jete kompetent juridiksioni i Republikës se Shqipërisë, me zbatimin e ligjeve shqiptare.

NENI 13

LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne përputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanërisht te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 14



REGJISTRIMI

Ky Akt Themelimi i Shoqërisë do të hyjë në fuqi pas regjistrimit, në regjistrat përkatës, nga organet publike kompetente.

NENI 15

DISPOZITAT E FUNDIT

Ky akt themelimi i shoqërisë "TATA AUTO Transport" Sh.p.k u hartua në bazë të vullnetit të lirë të themeluesit, në mbështetje të dispozitave përkatëse të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", të akteve të tjera ligjore. Hartohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) ekzemplare origjinale.

ORTAKU I SHOQERISE

"TATA AUTO Transport" Sh.p.k

Z. Redon META

Redon Meta

